



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

NJOFTIM

**“PËR ÇELJEN E GARËS PËR DHËNIEN E 4 (KATËR) LICENCAVE TË  
TRANSMETIMIT AUDIO ANALOGE PRIVATE”**

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), në mbështetje të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, rregullores “Për procedurat dhe kriteret për dhënie të licencës së transmetimit audio”, miratuar me vendimin nr. 153, datë 18.07.2016 të AMA-s, i ndryshuar, si dhe vendimit nr. 86, datë 08.10.2020 të AMA-s “Për çeljen e garës për dhënie të licencave të transmetimit audio analoge private”, në muajin nëntor 2020, do të organizojë procedurën e përzgjedhjes së kandidatave për dhënie të 4 (katër) licencave private të transmetimit audio analoge, të përbërë nga:

- licenca e shërbimit të programi audio;
- licencë për ndërtimin e operimin e rrjetit analog.

Për zonat e mëposhtme:

Nr.	Zona e ofrimit të shërbimit	Përcaktimi i operatorit	Pika transmetuese	Frekuenca (MHz)
1.	Qarqet Tiranë, Durrës	Audio Analoge Rajonale	Fushë Dajt	92.3
2.	Qarqet Tiranë Durrës	Audio Analoge Rajonale	Fushë Dajt	92.6
3.	Qarqet Elbasan Fier, dhe Vlorë	Audio Analoge Rajonale	Petresh	87.9
			Librazhd	89.6
			Gramsh	93
			Prrenjas	88.4
			Ardenicë	97.9
			Ligovun	95.1
			Ballsh	99.4
			Zvërnec	91.6
			Llogara	95.3
			Treblevë	96.3
			Himarë	94.9
			Sopot	105.1
Mile	95.5			
4.	Bashkitë Elbasan,	Audio Analoge Lokale	Petresh	96.3

	Cërrik, Belsh Gramsh		Gramsh	88.6
--	----------------------------	--	--------	------

Subjektet e interesuara për t'u pajisur me licencë private të transmetimit audio analoge, janë të lutur që të depozitojnë aplikimet në Autoritetin e Mediave Audiovizive, Rruga "Papa Gjon Pali II", Nr. 15, KP 1010, Tiranë, ***brenda datës 23.11.2020, ora 10.00.***

Dokumentacioni i plotë i konkurrimit të kandidaturave, që përfshin:

- Rregulloren "Për procedurat dhe kriteret për dhënien e licencës së transmetimit audio", e ndryshuar;
- Kushtet teknike të instalimit të pajisjeve transmetuese për secilën zonë të shpallur; (Pika e transmetimit, kanali, fuqia e transmetuesit);
- Kërkesat programore;
- Pagesat për licencën, taksat etj, të llogaritura për zonën në fjalë;

mund të tërhiqet në zyrën e Arkivë-Protokollit, në AMA pas kryerjes së pagesës në Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme, nga çdo subjekt që synon të marrë pjesë në konkurrim.

Aplikimet do të hapen ***në datën 23.11.2020, ora 10.00, në mjediset e AMA-s***, ku subjektet aplikues apo përfaqësuesit e autorizuar prej tyre, kanë të drejtë të jenë të pranishëm në momentin e hapjes së dosjeve të aplikimit.